

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Joint Stock Companies
Trepça Deoničarsko Društvo

Nr. 3881 Data. 05.05.2026
Mitrovica Mitrovica



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në bazë të Ligjit nr.03/L-212 të Punës neni 8 dhe neni 10 paragrafi 2 nëparagrafi 2.2 dhe 2.3, neni 22 paragrafi 4 i Statutit të Trepça Sh.A., neni 8 paragrafi 2 të Rregullores për Marrëdhënie pune në Trepça Sh.A., Trepça Sh.A me datë 05.05.2026 publikon këtë:

KONKURS PËR PUNË DHE DETYRA SPECIFIKE

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Titulli i pozitës së punës:	Saldues
Koeficienti/Paga	650€ bruto
Nr. i kërkuar	1
Kohëzgjatja e emërimit	Në periudhë të caktuar (4 muaj)
Data e njoftimit	05/05/2026
Afati për aplikim	06/05/2026- 20/05/2026
Institucioni	Ndërmarrja "Trepça Sh.A."
Njësia Biznesore	Fabrika e Pajimeve dhe Procesit

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Organizon saldimin nëpër grupe të vogla të salduesve;
- Saldimin e rezervuarve;
- Saldimin e gypave dhe përcjellëve të gazit;
- Saldimi i mbajtëseve të vinçit dhe shtyllave;
- Saldimi i konstruksioneve të ndërlikuara ku lajmërohen ndryshime mekanike;
- Gjatë saldimit ku kërkohet saldim i forte, i pastër dhe homogjen;
- Saldimi i pjesëve të plasaritura;
- Saldimi i gypave me shtypje të lartë;
- Saldimi në të gjitha pozitat;
- Saldimi i metaleve të ngjyrosura, lëgurave si dhe gizës;
- Saldimi i lidhëseve dhe konstruksioneve;
- Saldimi i gypave të ujit deri në 6Atm në kushte të vështira (kanale ,shakte, dhe lartësi);
- Saldimi i gypave dhe paimëve të nxehjes;
- Saldimi i pirunierëve, rrotave dhe llamarinës;
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhëresës së kryepunëtorit në kuadër të profesionit të vet;
- Obligohet t'i përmbahet rregullave të mbrojtjes në punë;
- Për punën e vet i përgjigjet kryepunëtorit.

2. Kriteret e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprë penale;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me ligj.

3. Kriteret e veçanta

- Shkalla e tretë e përgatitjes profesionale – Saldues;
- Duhet të ketë së paku 5 vite përvojë pune profesionale.

4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit

- Aplikacioni (i cili shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Deklarata nën betim (e cila shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Dëshminë e përvojës së punës profesionale;
- Dëshmi nga gjykata kompetente që dëshmon se aplikuesi nuk është i dënuar për veprë penale apo nuk është nën hetime jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- CV-Biografia;
- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Kopjet e dokumenteve mbi kualifikimin arsimor dhe / ose nostrifikimin për diplomat jashtë vendit.

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- a. Testimi me shkrim – 100 pikë
- b. Intervista – 300 pikë

6. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes e-mail dhe ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.” në linkun <https://trepcasha.com/>, tek kategoria Shpallje.

7. Mënyra e aplikimit

- Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zyrën e protokolit të Trepça Sh.A., në Menaxhmentin e Trepça Sh.A.-Parku Industrial në Mitrovicë, çdo ditë pune nga ora 08:00-16:00.

8. Shpallja e rezultateve përfundimtar

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.”.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Trepça Sh.A.

Kryeshefi Ekzekutiv

